



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT BERAT

Nr. 152/18 Prot

Datë 08/02/2023

V E N D I M

Nr. 2

Datë 08/02/2023

P Ë R

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT BERAT TË VITIT 2023, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT TË QARKUT NR.21, DATË 23.12.2022

Këshilli i Qarkut Berat pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e Projekt Buxhetit të ndryshuar të Këshillit të Qarkut Berat për vitin 2023, mbështetur në kuadrin ligjor si më poshtë :

- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 8, pika 2 ,neni 9 pika 1.1, b, neni 31 pika 1,2,3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligji Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 10/1 i vitit 2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
- Ligji Nr. 84/2022, “Për Buxhetin e vitit 2023”
- Udhëzimi plotësues nr.2, datë 19.01.2023 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”
- Ligje dhe akte nën ligjore të tjera.

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Qarkut nr.21, datë 23.12.2022 të bëhen shtesat si më poshtë:

A. Shtohet e ardhura e trashëguar në shumën totale 57,734,620.38 lekë nga të cilat:

a) Grant i trashëguar nga viti 2022	31,874,285.65	lekë
b) Të ardhura të trashëguara nga viti 2022	9,372,474.73	lekë
c) Grant i kushtëzuar (Bashkëfinancim e tvsh e projekteve)	16,487,860	lekë

b. Shpenzimet gjithsej shtohen në shumën	57,734,620.38	lekë
a) Shpenzimet kapitale shtohen në shumën	57,734,620.38	lekë
Nga të cilat:		
• Projekti "Ndriçim i Muzeut Etnografik"	3,014,344	lekë
• Projekti Rikonstruksion i godinës së Këshillit të Qarkut	38,232,416.38	lekë
• Projekti Tactical Tourism (Bashkëfinancim)	5,639,978	lekë
• Projekti Tactical Tourism (TVSII)	1,127,996	lekë
• Projekti Waste Rreact (Bashkëfinancim)	7,541,406.01	lekë
• Projekti Waste Rreact (TVSII)	2,178,480	lekë

2. Të miratojë ndryshimet si më poshtë:

Shtesa:

(Shifrat janë në lekë)			
Programi	Përshkrimi	Artikulli	Shuma
	Projekte "Ndriçim i Muzeut Etnografik"	231	1,985,656
04980	Fond rezerve	602	577,344
	Shuma e shtesave		2,563,000

Pakësime:

(Shifrat janë në lekë)			
Programi	Përshkrimi	Artikulli	Shuma
10430	Shpenzime për paga Qendra Sociale	600	1,341,000
10430	Shpenzime për sigurime Qendra Sociale	601	222,000
10430	Shpenzime operative Qendra Sociale	602	1,000,000
	Shuma e pakësimeve		2,563,000

2. Shpenzimet do të përdoren sipas pasqyrave pjesë e këtij vendimi.

3. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut.

4. Përgjegjësi i Sektorit të Financës autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për çdo muaj.

KRYETAR
Donald MOLISHTI

Këshilltarë gjithsej 18
Morën pjesë 10
Votuan Pro 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT BERAT
SEKTORI I FINANCËS ZHVILLIMIT RAJONAL E INVESTIMEVE

RELACION
PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT BERAT TË
VITIT 2023, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT TË QARKUT NR.21, DATË 23.12.2022

MBËSHTETUR NË KUADRIN LIGJOR NË VIJIM :

- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; neni 8, pika 2 ,neni 9 pika 1.1, b, neni 31 pika 1,2,3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligji Nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 10/1 i vitit 2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
- Ligji Nr. 84/2022, “Për Buxhetin e vitit 2023”
- Udhëzimi plotësues nr.2, datë 19.01.2023 “ Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”

- Grupi i punës në këtë projekt – vendim ka reflektuar shtesat dhe ndryshimet që ka pësuar buxheti i vitit 2023 pas rakordimeve me Degën e Thesarit Berat.
Sipas Akt-Trashëgimisë për të ardhurat e trashëguara për vitin 2023 të datës 06.02.2023 rezultoi se:

1. Trashëgohen 31,874,285.65 lekë nga granti, Kapitulli 01
2. Trashëgohen 9,372,474.73 lekë nga të ardhurat, Kapitulli 05
3. Trashëgohen 16,487,860.01 lekë nga granti i transferuar per projektet e huaja, Kapitulli 01

Këto vlera të cilat në total arrijnë vlerën 57,734,620.39 do ti shtohen buxhetit të vitit 2023 i cili në total me të gjitha burimet e financimit pa përfshirë transfertën e kushtëzuar për funksionet e deleguara (DAMT) dhe për Qendrën Sociale për të moshuarit “Shtëpia e Përbashkët” arrin vlerën 102,050,893.39 lekë.

Si pasojë e problemeve të shumta që vihen re në mesin e Këshillit të Qarkut sic është rrëzimi i suvasë së tavanit në hyrjen e institucionit dhe prezenca e lagështisë të cilat çenojnë veprimtarinë e institucionit, dëmtimi dokumentave në arkiv por edhe të arkivit të gjendjes civile të rrethit duke u bërë shkak për dëmtimin e këtyre dokumentacioneve të rëndësishme për qytetarët si pasojë e lagështisë që krijohet nga tubacionet e amortizuara është i domosdoshëm rikonstuksioni i mesinës, i instalimeve hidraulike, elektrike, përshtatja e shkallëve të emergjencës ndërtimi i të cilave është detyrim në ligjin për mbrojtjen nga zjarri si

Rikonstruksion i fasadës së godinës sipas preventivit bashkëlidhur në shumën 38,232,416 lekë nga të cilat 28,859,941.65 nga granti i trashëguar dhe 9,372,474.73 nga të ardhurat e trashëguara. Gjithashtu në vijim të projektit Tactical Tourism i cili konsiston në rikonstruksionin e Muzeut Etnografik për arsye se në projektin e hartuar nga BE nuk ishte parashikuar ndriçimi i këtij objekti propozohet të kryhet investimi I Këshillit të Qarkut "Ndriçim i Muzeut Etnografik" I cili sipas preventivit arrin vlerën 5000000 lekë nga të cilat 3014344 nga granti i trashëguar dhe 1985656 nga granti i vitit 2023 pasi pas çeljes së fondit për funksionimin e Qendrës Sociale për të moshuarit "Shtëpia e Përbashkët" nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shuma prej 2,563,000 lekë e planifikuar për shpenzimet e qendrës do të shpërndahet 1,985,656 lekë tek shpenzimet kapitale për ndriçimin e Muzeut Etnografik dhe 577,344 lekë do ti shtohen fondit rezervë.

Më konkretisht buxheti i vitit 2023 do të pësojë ndryshime, shtesa dhe pakësime sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela permbledhese e buxhetit te vitit 2023 sipas burimeve te financimit, e ndryshuar.

Nga granti i Pakushtezuar 2023			
Lloji i shpenzimit	Llogaria	Shuma leke	Ne mije leke
Shpenzime per paga	600	16,058,000	16,058
Shpenzime per sigurime shoqerore	601	2,655,000	2,655
Shpenzime operative	602	6,180,000	6,180
Transferta (Shoqata e Qarqeve)	602	500,000	500
Transferta(AER)	602	400,000	400
Investime (Projektet IPA)	231	12,460,273	12,460
Investime (Ndricim I Muzeut Etnografik)	231	1,985,656	1,986
Fondi Rezerve	602	577,344	577
Totali i Shpenzimeve nga Granti i pakushtezuar		40,816,273	40,816
Te ardhurat 2023	Llogaria	Shuma leke	Ne mije leke
Shpenzime operative (v.gjyqesore)	602	2,856,837	2856.837
Transferta (Shoqata e te verberve)	602	100,000	100
Taksa Vendore B.Berat	602	100,000	100
Fondi Rezerve	602	443,163	443.163
Totali i shpenzimeve nga te ardhurat e 2023		3,500,000	3,500
Granti i trashëguar nga viti 2022			
Investime "Ndricim I Muzeut Etnografik"		3,014,344	3,014
Investim "Rikonstruksion i godinës së Këshillit të Qarkut"		28,859,941.65	28,860
Totali i shpenzimeve nga granti i trashëguar nga viti 2022		31,874,285.65	31,874
Te ardhurat e trashëguara nga viti 2022			
Investim "Rikonstruksion i godinës së Këshillit të Qarkut"		9,372,474.73	9,372
Totali i shpenzimeve nga granti i trashëguar nga viti 2022 per projektet IPA			
Projekti Tactical Tourism (Bashkëfinancim)		5,639,978.00	5,640
Projekti Tactical Tourism (TVSH)		1,127,996.00	1,128
Projekti Waste Rreact (Bashkëfinancim)		7,541,406.01	7,541
Projekti Waste Rreact (TVSH)		2,178,480.00	2,178
Totali i shpenzimeve nga granti i trashëguar nga viti 2022 per projektet IPA		16,487,860.01	16,488
Total buxheti		102,050,893.39	102,051

Ju faleminderit!

Grupi i punës